



Revista

E KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR

Nr. 70 • Viti XXI i botimit • 2017 • www.kksh.org.al

Së bashku, përballojmë çdo vështirësi!



... Dimër 2017...



ORGAN I KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR,
SHPËRNDAHET FALAS.

Kryqi i Kuq Shqiptar është shoqata më e vjetër humanitare në Shqipëri. Ai është themeluar në 4 tetor të vitit 1921 dhe është njohur zyrtarisht nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në vitin 1923. Po në atë vit, ai është anëtar i Federatës (në atë kohë Ligës) Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, si shoqata e 38-të e themeluar deri atëherë. Kryqi i Kuq Shqiptar është pjesë e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Sipas nenit 1 të Ligjit Nr.7864 për Kryqin e Kuq Shqiptar, të miratuar nga Parlamenti Shqiptar më datë 29.9.1994, Kryqi i Kuq Shqiptar është një shoqatë humanitare vullnetare që e ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur në bazë të Parimeve themelore të Lëvizjes ndërkombëtare humanitare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe dhe të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 - ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 27 maj 1957 - dhe të Protokolleve shtesë të Konventave të Gjenevës të 10 qershorit 1977 - ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 16 qershor 1993. Ai është ndihmës i organeve të pushtetit për çështjet humanitare në vend.



V I Z I O N I

Kryqi i Kuq Shqiptar synon të jetë një shoqatë humanitare e zhvilluar, që punon për përmirësimin e jetës dhe dinjitetit të njerëzve në nevojë, në përputhje me parimet themelore të Lëvizjes.

M I S I O N I

Kryqi i Kuq Shqiptar ndihmon, nëpërmjet veprimtarisë së vet humanitare, njerëzit më në nevojë duke mobilizuar forcën e humanizmit të shoqërisë shqiptare.

Këshillit Botues

Redaktori përgjegjës:

Zamir Muça

Lutemi të dërgoni artikujt, materialet tuaja

apo kërkesë për informacion në adresën:

Kryqi i Kuq Shqiptar, Rr. Muhamet Gjollësja,

Kutia Postare 1511, Tiranë

Recepsioni: + 355 4 2 257 532

Tel/Fax: + 355 4 2 225 855 + 355 4 2 222 037

Email: kksh@kksh.org.al

Faqja në internet: <http://www.kksh.org.al>

Redaksia falënderon të gjithë anëtarët, vullnetarët, të

PËRMBAJTJA

– Kryqi i Kuq Shqiptar, një shoqatë që funksionon mirë	Faqe	3
– Roli dhe përgjegjësitë e të zgjedhurve dhe të të punësuarve në Kryqin e Kuq Shqiptar	Faqe	4
– Kryqi i Kuq Shqiptar dhe situatat emergjente të dimrit 2016- 2017	Faqe	7
– Konkursi II kombëtar “Rina dhe Kryqi i Kuq”, një projekt me rininë për përhapjen e vlerave humanitare te të rinjtë	Faqe	10
– Rubrika e Shëndetit: Virozat e stinës së Pranverës	Faqe	12
– “Jo indiferentizmit... Po solidaritetit”, një fushatë në ndihmë të fëmijëve sirianë	Faqe	13
– Shoqëria jonë ka nevojë të edukohet me njerëzoren	Faqe	14
– Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Kryqit të Kuq Shqiptar dhe Kryqit të Kuq të Kosovës	Faqe	15
– Një letër falënderuese	Faqe	15
– Nga veprimtaritë e Kryqit të Kuq Shqiptar dhe të Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe	Faqe	16


punësuarit në KKSH dhe bashkëpunëtorët jashtë tij, për ndihmën e dhënë në nxjerrjen e këtij numri të revistës. Revista e Kryqit të Kuq Shqiptar del tri herë në vit në një tirazh prej 1500 kopje. • Revista shpërndahet falas. • Opinione e shprehura janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht opinionin e Kryqit të Kuq Shqiptar. Çdo artikull i dërguar, por jo i kërkuar është i mirëpritur por nuk do të kthehet. • Redaksia rezervon të drejtën që të redaktojë artikujt. Artikujt dhe fotografitë që nuk i nënshtrohen të drejtës së autorit mund të rishkruhen pa një autorizim paraprak, lutemi citoni Kryqi i Kuq Shqiptar. • Shkrimet e publikuar në këtë revistë kanë një vlerë tërësisht informative dhe janë të zhvësura nga çdo lloj nënkuptimi politik.

Kryqi i Kuq Shqiptar, një shoqatë e përgjegjshme, me integritet dhe transparencë

Më 23 dhjetor 2016, në prag të festave të fundvitit, në Selinë e Kryqit të Kuq Shqiptar mbërriti si dhuratë, një letër e Dr. Muctarr Jalloh, Kryetar i Komitetit të Përputhshmërisë dhe Ndërmjetësimit në Federatën Ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe (Federatës), me anë të së cilës u njoftuam se Kryqi i Kuq Shqiptar i përmbushte të gjitha kriteret e përcaktuara nga ky Komitet, për vlerësimin e shoqatave kombëtare në lidhje me integritetin, përgjegjësinë dhe transparencën kundrejt Federatës. Qëllimi i përgjithshëm i këtij vlerësimi, ishte që të tregonte se sa i përmbushin shoqatat kombëtare, detyrimet e tyre, të përcaktuara në nenin 8 të Statutit të Federatës.

1. Shoqata kombëtare kontribuon në *Sistemin raportues të të dhënave të Federatës*;
2. Shoqata kombëtare ka deklaruar *situatat financiare* gjatë tri viteve të fundit, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Financës së Federatës;
3. Shoqata kombëtare realizon *auditim të jashtëm*;
4. Shoqata kombëtare paraqet *Raport Vjetor të veprimtarisë*;
5. Shoqata kombëtare *nuk është referuar në Komitetin e Përputhshmërisë dhe Ndërmjetësimit* për shkak të ndonjë dyshimi për thyerje të integritetit;
6. Shoqata kombëtare *e ka rishikuar statutin e vet gjatë dhjetë viteve të fundit* ose është në proces rishikimi;
7. Shoqata kombëtare *e bën pagesën e kontributit statutor*, sipas afateve të përcaktuara nga Rregullorja Financiare e Federatës;
8. Shoqata kombëtare *nuk konsiderohet me probleme nga Bordi Drejtues*.

Shoqata kombëtare *nuk konsiderohet me probleme* nga Bordi Drejtues. Pas këtij vlerësimi, Kryqi i Kuq Shqiptar bën pjesë në gjirin e 50 shoqatave kombëtare më të mira, ndër 190 shoqata anëtare që numëron gjithsej, Federata



Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe e Gjysmëhënës së Kuqe. Ky përcaktim është rezultat i punës së palodhur në vite, i anëtarëve vullnetarëve dhe punonjësve të Kryqit të Kuq Shqiptar, si dhe i kontributit të vyer të të gjithë dashamirësve dhe donatorëve të tij brenda dhe jashtë vendit.

Nuk mund të kishte finalizim më të bukur, viti jubilar i 95 vjetorit të Kryqit të Kuq Shqiptar se sa nëpërmjet një vlerësimi të tillë. Përveç kënaqësisë së merituar dhe krenarisë së ligjshme, ky sukses është edhe një obligim i madh për rritjen e përgjegjësisë në të ardhmen, për ruajtjen dhe për çuarjen përpara të arritjeve të deritanishme.

Artur Katuçi
Sekretar i Përgjithshëm



interes të përmbushjes së misionit të Shoqatës, edhe kontributin e tyre, duke marrë pjesë në aktivitete konkrete të saj, si në nivel lokal dhe në nivel qendror. E shprehur ndryshe dhe në një mënyrë pak më të thjeshtë, anëtarët e regjistruar dhe anëtarët aktivë, janë “pronarët”

Në jetën e brendshme dhe organizimin e veprimtarive humanitare, në përmbushje të misionit që ka marrë përsipër të realizojë, Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSJ) mbështetet në dokumentet bazë të tij, Statuti i KKSJ dhe Rregullorja e Brendshme e KKSJ. Këto dy dokumente si dhe rregullore të tjera, së bashku me vendimet e marra nga organet më të rendësishme drejtuese të Shoqatës, Asambleja Kombëtare dhe Këshilli Drejtues, përbëjnë kornizën ligjore mbi të cilën ngrihet dhe organizohet e gjithë veprimtaria e tij. Asnjëherë dhe për asnjëlloj arsye, Shoqata nuk duhet të kryejë veprimtari apo të ndërmarrë veprime që bien ndesh me këtë kornizë ligjore.

Anëtarët e Asamblesë Përgjithshme dhe të Këshillit Drejtues të Shoqatës janë anëtarët më aktivë dhe më të përkushtuar të saj, të cilët përfaqësojnë në këto organe gjithë masën e madhe të anëtarëve të KKSJ, që i bashkohen Shoqatës pasi ndajnë me të, të njëjtin vizion e dëshirë, që synon përmbushjen e misionit të KKSJ.

Statuti i KKSJ parashikon dy kategori anëtarësh, anëtarët e regjistruar dhe anëtarët aktivë. Këta të fundit, në gjuhën e përditshme të Shoqatës, quhen ndryshe vullnetarë. Anëtarët e regjistruar janë ata shtetas shqiptarë, të cilët pranojnë statutin e Shoqatës, paguajnë kuotizacionin si dhe, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në mbledhjet e përgjithshme të degëve të KKSJ, kanë të drejtën të zgjedhin dhe të zgjidhen. Vullnetarët, siç përmendet në nenin 8 të Statutit, janë ata shtetas shqiptarë, të cilët krahas së qenit anëtar i regjistruar i KKSJ, ofrojnë, në

e shoqatës, të cilët, e drejtojnë atë nëpërmjet organeve si: në nivel lokal, Këshilli i Degës dhe Mbledhja e anëtarëve dhe, në nivel qendror, Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Drejtues.

Mbledhja e anëtarëve, në nivel lokal, zgjedh Kryetarin e Degës së KKSJ ndërsa, Asambleja e Përgjithshme zgjedh Presidentin e Shoqatës. Këta të zgjedhur, drejtojnë punët e Shoqatës në nivel lokal dhe qendror. Në vija të përgjithshme, ky është organizimi i shoqatës, i mbështetur në dy komponentët përbërës të saj, atë të anëtarëve dhe të vullnetarëve, të përfaqësuar në organet drejtuese nga të zgjedhurit.

Në kushtet kur Shoqata kërkon të zgjerojë aktivitetin e saj dhe në një mjedis gjithnjë e më kompetitiv, anëtarët dhe vullnetarët pra, “pronarët” e Shoqatës, e kanë të pamundur ndjekjen nga afër të të gjitha veprimtarive të saj. Në kohën e sotme, në çdo sektor të shoqërisë, si në atë privat dhe në atë publik e shtetëror, punohet mbi bazën e projekteve konkrete, hartimi dhe realizimi i cilëve kërkon profesionalizëm dhe ekspertizë. Për këtë arsye, shoqata, nëpërmjet Këshillit Drejtues, angazhon individë më aftësi të vecanta, të cilët duhet të jenë në gjendje të hartojnë e realizojnë strategji e projekte dhe të ndjekin e realizojnë punët e përditshme të shoqatës.

Për këtë, Këshilli Drejtues i Shoqatës emëron një Sekretar të Përgjithshëm, nën varësinë e të cilit vihen të gjithë të punësuarit e shoqatës, si në nivel qendror dhe në nivel lokal, si dhe miraton një organigramë të të punësuarve në nivel lokal e qendror. Të punësuarit janë të angazhuar me kohë

të plotë për kryerjen e veprimtarive të miratuara nga organet e zgjedhura të Shoqatës. Në nivel lokal, rekrutimi i të punësuarve bëhet në vartësi të kapaciteteve lokale. Në këtë aspekt, të punësuarit e shoqatës, përbëjnë komponentin e tretë të saj.

Ekzistenca e këtyre komponentëve në shoqatën e KKSJ krijon nevojën e përcaktimit të roleve të secilit, si dhe të detyrave e përgjegjesive që do kenë në përpjekjet e tyre për të përmbushur si duhet misionin e Shoqatës. Në këtë mënyrë, roli i të zgjedhurve është përcaktuar se fokusohet në drejtimin e Shoqatës dhe, thënë ndryshe, ka në qendër të vëmendjes përgjigjet që i jepen pyetjes: “Çfarë bën shoqata për të përmbushur misionin e saj”?; ndërkohë që të punësuarit fokusohen në përcaktimin e hapave që duhen hedhur dhe të rrugëve që duhen ndjekur për realizimin e Strategjisë pesëvjeçare të Shoqatës, Planit vjetor të Veprimtarive e projekteve të miratuara, duke iu përgjigjur, në një farë mënyre pyetjes, “Si veprojnë të punësuarit e shoqatës për përmbushjen e detyrave të ngarkuara?”.

Nga sa u shpjegua, natyrshëm mund



të lindë pyetja se cili do të jetë raporti ndërmjet të zgjedhurve të Shoqatës, pra anëtarëve të organeve drejtuese, në nivel lokal dhe në nivel qendror, dhe të të punësuarve të saj. Opsionet më të mundshme janë dy: raporte varësie apo raporte partneriteti?

Në literaturën juridike por dhe me gjerë, mbizotëron parimi se; “kush financon, urdhëron”. Në rastin tonë, meqënëse të punësuarit rekrutohen nga të zgjedhurit e Shoqatës dhe për punën e tyre, financohen prej saj, të krijohet përshtypja se raporti ndërmjet të zgjedhurve dhe të të punësuarve do të jetë raport varësie. Kështu ndodh në biznesin privat dhe në strukturat shtetërore, por nuk është rasti të ndodhë kështu në një shoqatë humanitare siç është KKSH, e cila ka zgjedhur të adoptojë një qasje tjetër, atë të partneritetit. Kjo do të thotë që të zgjedhurit e Shoqatës lënë mënjanë çështjen e financimit dhe i kërkojnë të punësuarve që të ndjehen njëjloj, si vetë ata, në punën që duhet të kryejnë për çështje si: vullnetarizmi, anëtarësia, grupet shenjë që duhen adresuar, kontributi për lehtësimin e sa më shumë vuajtjeve të individëve

të grupeve shenjë, përhapja e vlerave humanitare në shoqëri, imazhi i Shoqatës, marrëdhëniet me organet e pushtetit dhe partnerët, etj.

Në këtë mënyrë, komponentët përbërës të Shoqatës, ndajnë ndërmjet tyre role e përgjegjësi në përpjekjet e kontributet e tyre për realizimin e misionit humanitar të saj, duke respektuar njëri tjetrin si dhe duke i krijuar mundësitë e lehtësitë e nevojshme secilit, me synimin që Shoqata të funksionojë në normalitet të plotë dhe njerëzit në nevojë të jenë përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij procesi.

Përse Shoqata është e prirur që marrëdhëniet ndërmjet të zgjedhurve dhe të të punësuarve t'i konsiderojë si marrëdhënie partneriteti dhe jo varësie? Disa nga arsyet janë këto:

Duke qënë se shoqata është një institucion me karakter humanitar, që synon lehtësimin e vuajtjeve dhe plotësimin e nevojave të njerëzve më në nevojë, vlerëson se përkushtimi për arritjen e qëllimit, si nga ana e të zgjedhurve dhe nga ana e të punësuarve, do të ishte më i përshtatshëm në marrëdhënie partneriteti se sa në

marrëdhënie vartësie e komandimi;

Në mjaft situata, të zgjedhurit e Shoqatës, kanë të drejtën e aplikimit në praktikë të parimit “double hat”, që do të thotë se, ata veprojnë si të zgjedhur dhe si të punësuar në kohë të ndryshme. Kjo nënkupton që kur ata janë në mbledhjen e strukturës ku janë zgjedhur apo kur ndjekin probleme, të ngarkuara nga kjo strukturë, do të thotë sepo merren me çështje që lidhen me drejtimin e Shoqatës, ndërsa, në rastet kur ata marrin pjesë direkt në realizimin e projekteve të caktuara, duke u vënë nën vartësinë e drejtuesit të këtij projekti, i cili është i punësuar, do të thotë se merren me probleme menaxhimi. Këtë “privilegj” e kanë vetëm të zgjedhurit, ata vullnetarë të cilët e ndejnë veten të aftë që, përpos kontributit të tyre si të zgjedhur, kanë ekspertizën dhe disponojnë kohën e mjaftueshme për të kontribuar direkt në realizimin e projekteve të caktuara. Marrëdhënia e partneritetit dhe jo ajo e vartësisë mundëson një jetësim më efektiv të këtij realiteti.

Demokratizimi i vazhdueshëm i shoqërisë ka sjellë në vijueshmëri, partneritetin si aspekt të rëndësishëm



të raporteve ndërmjet hallkave, enteve, elementëve përbërës, strukturave, bile edhe vetë shteteve. Sot në botë flitet gjithnjë e më shumë për vende partnere, shërbime partnere, organizma partnere, etj. Sa më shumë realiteti i vartësisë së një organi ndaj një tjetri humbet terren, aq më tepër themi se kjo strukturë po hedh hapa drejt demokratizimit dhe ndarjes së roleve e përgjegjësive në përpjekjet për arritjen e objektivave dhe misionit.

Jeta ka të papriturat e saj dhe hera herës ndodh që kufiri ndërmjet të qenit vulnerabël dhe ofrimit të kontributit për të ndihmuar individët vulnerabël është jo vetëm pranë por dhe reversibël. Kjo do të thotë që në një fatkeqësi natyrore, vulnerabël mund të jetë një pjesë e komunitetit ku jetojnë edhe vullnetarët e Kryqit Kuq, pse jo dhe të zgjedhur apo dhe të punësuar. Një marrëdhënie partneriteti në radhë të Shoqatës do të ishte më e vlefshme dhe e efektshme në lehtësimin e vuajtjeve të më nevojtarëve në këto raste, se sa marrëdhënia e varësisë, ku në jo pak raste, manifestohen arsye animoziteti dhe sensibilitete negative që shmangin transmetimin e energjive pozitive, aq të nevojshme në këto situata.

Marrëdhëniet ndërmjet Presidentit të Shoqatës dhe Sekretarit të Përgjithshëm në nivel qendror dhe ndërmjet Kryetarit të Degës dhe Sekretarit të Degës në nivel lokal, janë mjaft të rëndësishme për t'i dhënë jetë këtij partneriteti. Njohja e venia në zbatim prej secilit, e rolit dhe përgjegjësisë që ka në këtë proces, është problem jetik për Shoqatën.

Në këtë mënyrë, përcaktohet se të zgjedhurit janë të fokusuar në çështje që kanë të bëjnë me drejtimin e Shoqatës, duke kërkuar zbatimin e vendimeve që miratojnë, duke i lënë të punësuarve menaxhimin e punëve të përditshme e veprimtarive konkrete të saj.

Të zgjedhurit zbatojnë me përkushtim detyrimet e tyre, duke mos lejuar ndërhyrje nga të punësuarit në probleme të jetës së brendëshme që lidhen me drejtimin e shoqatës. Kjo do të thotë që të punësuarit nuk duhet të përfshihen në asnjë rast e për asnjë lloj arsye në problemet e natyrës së vendimmarrjes së shoqatës, në mënyrë të veçantë, të ndërhyjnë apo të kërkojnë të ndikojnë në problemet zgjedhore të Shoqatës gjatë fushatave zgjedhore, si në nivel lokal dhe në nivel qendror.

Nga ana e tyre, të zgjedhurit nuk ka përse të përfshihen në aktivitete të punës së përditshme që realizojnë të punësuarit. Kjo u është besuar atyre, të cilët janë ekspertë të fushave përkatëse që mbulojnë dhe, për veprimtarinë e tyre, informojnë dhe raportojnë, sipas kërkesës, në strukturat e organeve të zgjedhura.

Është e papranueshme që ndërmjet të zgjedhurve dhe të të punësuarve të shfaqen raste të ortakërisë në punë. Një fenomen i tillë duhet të jetë i papranueshëm dhe nuk duhet të lejohet të ndodhë, për arsyen e thjeshtë se çënon drejtpërdrejtë parimin e ndarjes së roleve dhe përgjegjësive të secilit individ në Shoqatë, duke minuar thelbin e funksionimit të Shoqatës.

Në këtë optikë, marrin rëndësi të veçantë roli i Presidentit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Shoqatës. I pari, për të marrë masat e nevojshme që strukturat e të zgjedhurve të të gjitha niveleve të luajnë rolin e tyre dhe të mbajnë përgjegjësitë e drejtimit të Shoqatës, ndërsa i dyti, në organizimin e punëve të përditshme, në hartimin e zbatimit e planeve strategjike e projekteve, në moslejimin e të punësuarve në përfshirjen e tyre në punët e të zgjedhurve, por të jenë mbështetës dhe ndihmës të strukturave të të zgjedhurve në vazhdimësi.

Një ndarje e tillë e roleve dhe

përgjegjësive në shoqatën e KKSHT konsiderohet si gjetja më e përshtatshme për funksionimin si duhet të Shoqatës. Kjo është fryma që përçohet nga dokumentet bazë të kornizës juridike të Shoqatës si dhe nga dokumente të strukturave të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.

Historia e periudhës së pas viteve '90, kur shoqata e KKSHT u riorganizua pas një ndërprerje 20 vjeçare të veprimtarive të saj, karakterizohet nga një larmi ngjarjesh e aktiviteteve, pjesa më e madhe e të cilave kanë pasur lidhje të drejtpërdrejtë me mjedisin politik e social dhe vështirësitë e shoqërisë shqiptare gjatë tranzicionit të gjatë drejt një shoqërie demokratike dhe kanë qenë, në një farë mënyre, reagim ndaj këtyre situatave. Ngjarje të tilla si: operacioni i ndihmave ushqimore në disa nga zonat më të varfra të vendit, përgjigjja ndaj situatës së krijuar në vend pas rënies së firmave piramidale, kontributi gjatë krizës së refugjatëve nga Kosova, përgjigjja, në mënyrë të përsëritur, ndaj situatave të reshjeve të mëdha të dëborës dhe të përmbytjeve në vend, kanë qenë ngjarje në të cilat, të zgjedhurit dhe të punësuarit e Shoqatës, kanë luajtur në mënyrë korrekte dhe të drejtë si duhet rolin e tyre.

Në të gjitha këto situata, organet drejtuese të Shoqatës, kanë përcaktuar drejt dhe kanë marrë vendime se çfarë duhet të bënte Shoqata në përgjigje të këtyre ngjarjeve, për të qenë sa më e pozicionuar të përmbushje të misionit të saj humanitar. Nga ana tjetër, të punësuarit e Shoqatës, nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm, kanë organizuar punët e përditshme duke bërë të mundur realizimin e vendimeve të përcaktuara nga të zgjedhurit e Shoqatës.

Mbajtja parasysh dhe zbatimi si duhet në praktikë, në mënyrë të vazhdueshme i roleve dhe përgjegjësive të të zgjedhurve dhe të të punësuarve, do të ndikojë vazhdimisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin si duhet të misionit të Shoqatës.



Kryqi i Kuq Shqiptar dhe situatat emergjente të dimrit 2016- 2017

Ndryshimet klimatike, reshje tepër të dendura për një kohë të shkurtër apo temperatura ekstreme mjaft të ulëta në vende jo normale për to, të kombinuara këto dhe me vulnerabilitetin në zona të ndryshme si ndërtime pa lejë, bllokim kanalesh, infrastrukturë e pa zhvilluar dhe jo e mirëmbajtur, shërbime sociale jo në nivelin e duhur, etj. bëjnë që të krijohen situata emergjente me pasoja në njerëz, apo dëme materiale.



Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSJ) ka në misionin e tij të përgatitet për situata të tilla dhe të veprojë për të lehtësuar sadopak familjet e prekura prej tyre.

Kështu ndodhi në vendin tonë, ku brenda një periudhe të shkurtër, ndodhën dy emergjenca njëra pas tjetrës, përmbytje në fundin e vitit 2016 dhe dimër i ashpër në fillim të vitit 2017. Reshjet tepër të dendura në 3-4 ditë, deri 180 mm, në Veri dhe në Lindje të Shqipërisë, bënë që disa lumenj të dalin nga shtrati në vende me bllokime apo ngushtime të rrjedhës tyre, duke sjellë një situatë emergjente në disa zona e qytete të banuara. Nga dalja e Lumit Zezë pati përmbytje në Fushë-Krujë, nga dalja e Lumit të Tiranës përmbytje në rrethinat e Tiranës, nga dalja e Lumit Erzen përmbytje në Shijak dhe Durrës, Lumi Drin përmbyti familje në Dibër, në Lezhë dhe Shkodër, Lumi Mat përmbyti disa familje në Mat, Lumi Vjosë pati përmbytje në Vlorë. Ajo që e dallon këtë

përmbytje nga përmbytjet e ndodhura më parë, ishte se u zhvillua shumë shpejt si emergjencë, që mund të quhen “flesh floods”. Brenda 1 jave, numri i familjeve të prekura në zonë të përmbytur nuk ishte i madh, por numri i zonave të prekura, kryesisht buzë lumenjve, në gjithë vendin ishte i tillë.

Në bashkëpunim me autoritetet vendore, degët e prekura nga përmbytjet, organizuan punën për hartimin e listave dhe shpërndarjen e menjëhershme të ndihmave për familjet përfituese. Ato mobilizuan vullnetarët më aktivë të skuadrave për raste katastrofash dhe filluan menjëherë shpërndarjen.

Në një nga këto shpërndarje, të organizuar në zonën e Bregut të Lumit në periferi të Tiranës, morën pjesë Presidenti i KKSJ, z. Ylli Alushi dhe Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë z. Blendi Klosi, dhe përfaqësues nga Bashkia Tiranë.

E ndërsa vazhdonim operacionin e

Skrapar, Gjirokastrë, etj.

Kryqi i Kuq Shqiptar tashmë me eksperiencë për të vepruar në situata të tilla, në të dyja rastet, ndoqi nga afër situatën në zonat më problematike dhe organizoi operacionin e ndërhyrjes në ndihmë të familjeve në nevojë. Përfaqësues të degëve të KK në këto zona morën pjesë në mbledhjet e Komisioneve të Menaxhimit të Emergjencave Civile me qëllim koordinimin e veprimeve të ndihmës. Ndërkohë në disa zona të tjera u evidentuan gjithashtu dhe familje të varfra buzë lumenjve në zona të tjera dhe jug të vendit me qëllim shtrirjen e ndihmës edhe në këto degë të vogla me mundësi të pakta financiare si Peqin, Patos, Tepelenë, Gjirokastrë, Delvinë, Skrapar, Sarandë etj.

Në të dyja situatat e emergjencës, nga KKSJ, Selia dhe Degët e KK në zonat e prekura morën masat përkatëse për përgatitjen organizimin dhe zbatimin e operacionit të ndihmës.



Operacioni i ndihmës pati këto aspekte: U bë vlerësimi paraprak për dëmet dhe evidentuan familjet më në nevojë në zonat më të prekura nga dimri dhe në gjendje sociale të vështirë;

Degët e KK mobilizuan vullnetarët e skuadrës së për raste katastrofash, të cilët ndihmuan në monitorimin e situatës, mbledhjen e informacionit, shpërndarjen e ndihmave. Ndërkohë Dega e KK Tiranë, për familjet e evakuara në 3 shkolla "Gramos Palushi", "Ramazan Jarani", "Kolë Jakova" dhe ato të strehuara në qendrat sociale për shkak të ngricave, ndihmoi me ushqime të gatshme rreth 300 persona, kryesisht familje rome.

Nga stoku i KKSHT për raste katastrofash, filloi menjëherë shpërndarja në zonat më të prekura, në Fushë-Krujë për 150 familje, në Lezhë

bashkëpunim për emergjencën e dimrit, për t'u ardhur në ndihmë familjeve më të varfra në zonat ku kalon gazsjellësi. Bëhet fjalë për një ndihmë prej 84.600 Euro në ndihmë të 1300 familje të izoluar nga dimri dhe në nevojë në Devoll, Korçë, Skrapar, Berat, Ura Vajguore deri në Fier, si dhe në disa zona të tjera të vendit. Ndihma e ofruar përbëhej nga një pako standard familjare një mujore 20.5 kg, 20 kg miell, 5 copë batanije dhe një kit higjienikë një mujor.

Në organizim të operacionit, stafi i selisë, organizoi në një kohë të shpejtë ndihmën dhe ambalazhimin e saj pako me logo të të dy institucioneve (KKSHT & TAP) dhe shpërndarjen e saj sipas një plani të detajuar. Shpërndarja e kësaj ndihme u realizua në kohe rekord prej 2 javësh, falë mobilizimit të vullnetarëve dhe të stafit të KK në seli dhe në degët

Dimri i ashpër, dhe veprimtaritë e Kryqit të Kuq, Dega Korçë në këtë fillim viti.

Dimri i ashpër, me reshje të shumta bore dhe temperatura të ulëta që arritën deri -18 gradë celsius, krijoi mjaft vështirësi si në Korçë. Në një situatë të tillë emergjente, Dega e KK Korçë, e përqëndroi veprimtarinë e saj në në përballimin e kësaj situatë të pazakontë. Puna filloi me shpërndarjen e ndihmave ushqimore dhe veshjeve për individë e familje në nevojë. Por të parë t që përfituan ishin 10 individë endacakë që jetonin në rrugët e qytetit. Në bashkëpunim me Bashkinë Korçë dhe Drejtorinë e Shërbimit Social Shtetëror u mundësua strehimi dhe ushqimi i tyre, duke i kaluar nga rruga në mjediset pritëse, me kushte optimale strehimi dhe ushqimi.

Krahas kësaj Dega e KK Korçë, në bashkëpunim me Shoqërinë TAP (Trans Adriatik Pipe Line) ndërmori një operacion të gjerë ndihmë në mbështetje të familjeve në nevojë me ndihma ushqimore, në zonat rurale dhe urbane të Rajonit të Korçës. Ky operacion filloi më 13 Janar e vazhdoi deri në ditët e para të muajit shkurt. Janë 482 familje që përfituan ndihma ushqimore dhe batanije, nga të cilat 211 familje në Bashkinë Devoll, 231 familje në Bashkinë Korçë dhe 40 familje në Bashkinë Maliq.

Ndërkohë vetë Dega e KK Korçë mbështeti me ndihma ushqimore 51 familje të evidentuara nga vullnetarë të degës.

Krahas punës në përballimin e situatës së vështirë të krijuar nga dimri i pazakontë, Dega KK Korçë nuk la pas dore veprimtaritë e tjera të planifikuara, si trajnimi për Ndihmën e Parë me stafin e Qendrës Shënd etësore, Libonik;

Në përgjigje të emergjencave të dimrit të fundit 2016-2017, Kryqi i Kuq Shqiptar ndihmoi 2720 familje:

Mbështetur nga FNKK&GJK	1000 familje
Mbështetur nga KK Gjerman	350 familje
Mbështetur nga Kompanisë TAP	1300 familje
Mbështetur nga fondet e KKSHT	70 familje

për 50 familje, në Shijak për 20 familje, si dhe u shpërndanë 300 batanije për personat e evakuuar në qendrat sociale.

Ndërkohë, njoftuam dhe përgatitëm informacion për emergjencën për Federatën në Budapest e mandej u përgatit dhe lëshua Apeli me Federatën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq në Gjenevë. Apeli u miratua në një afat kohor të shpejtë, brenda 1 jave, në shumën 138 mijë CHF, nëpërmjet të cilit u ndihmuan 1 000 familje të prekura nga përmbytja, ndërkohë që KK Gjerman mbështeti ndihmesën e 350 familje të përmbytura dhe të varfra në zona të tjera të prekura në jug të vendit në një shumë prej 20 000 euro.

Situata e dimrit dhe veprimet e menjëhershme të KKSHT, shkaktuan sensibilitet në institucione operojnë në vendin tonë. Një ndër to ishte dhe kompania TAP sh.a. (Trans Adriatik Pipline), e cila i ofroi KKSHT një

e përfshira.

Nga fillimi i operacionit të shpërndarjes për përmbytjen më 6 Nëntor e deri në mes të shkurtit 2017, kur përfundoi shpërndarja për emergjencën e krijuar nga moti i ftohtë, janë ndihmuar 2720 familje gjithsej, në 28 degë të KKSHT nga 39 degë që ka shoqata, duke qenë kështu një nga operacionet e ndihmës, nga më të mëdhat e realizuar deri tani nga shoqata.

Koordinatori i Programit për Katastrofa dhe Ndihma e Parë
Fatos Xhengo



veprimtaritë e Programit Social, në 4 qendrat e moshës së tretë në mbështetje të 200 të moshuarve; veprimtaritë e Programit të Shëndetit, ku në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Arsimit, Korçë u mundësuan biseda për higjienën personale, seanca mbi HIV/AIDS-in dhe takime me temë “Jo, drogës, alkoolin, duhanin” në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

Në përmbyllje me sukses të operacionit humanitar, dhe në realizimin e veprimtarive të programeve të tjera duhet vlerësuar angazhimi i të rinjëve vullnetarë, të cilët me entuziazëm përballuan kushtet e vështira të motit për të qenë pranë njerëzve në nevojë.

Përfituesit shprehen

Me z. Bajram Osmani, një nga përfituesit:

Doja shumë të thosha dy fjalë për KK. Në këtë dimër të acartë që kaluam, KK dhe Emergjencat Civile ishin ata që shpërndanë ndihma për familjet në nevojë. Të paktën ku jetojmë... E falënderoj shumë KK, dhe ju sepse na ndihmuat në ato ditë të ftohta dhe të acarta. Vetëm një shoqatë si Kryqi i Kuq dhe vullnetarët e saj, do të arrinin ta bënë këtë humanizëm.



Ajo që na u dha ishte më shumë se ndihmë. Në një kohë të acartë, batanijet janë më shumë se të nevojshme, sepse siç e shihni unë jam aftësi të kufizuar. Unë jetoj vetëm me nënën që dhe ajo është e sëmurë. Aq më tepër ushqimet. Një rezervë ushqimore të jep siguri. Faleminderit të gjithë juve që na e bëtë të mundur këtë ndihmë.

Përshëndetje nga z. Bashkim Doda. Përfitues nga ndihmat e KK.

Z. Bashkim Doda, banor në një shtëpi të improvizuar në ambientet e ish-fermës së Kastriotit, ku çfarë fryn jashtë, bie brenda, jeton vetëm me asistencë sociale prej 2 000 lek të reja, me një vajzë të divorcuar në shtëpi, shprehet me lot në sy se në ato ditë të acarta, në shtëpi nuk kishte as më të voglën rezervë ushqimore. “Nuk ka më keq se kur nuk ke çfarë t’u japësh fëmijëve për të ngrënë, shprehet ai. Faleminderit për ushqimet dhe miellin. Një mbështetje e vlefshme ishin dhe batanijet dhe rrobat për fëmijë. Ju falënderoj vërtet!!! ...

Përshtypje nga vullnetarët

Unë jam Renato Rustani. Jam vullnetar i Kryqit të Kuq nga 2015. Dimri këtë vit, ishte i ashpër dhe i acartë. Shumë familje u izoluan nga dëborë e akulli. Ishte e nevojshme që të bëhej një ndërhyrje dhe të ndihmoheshin këto familje. Si gjithmonë, Kryqi i



Kuq Shqiptar ishte në gatishmëri. Së bashku me disa vullnetarë të tjerë, bashkëmohatarë, ishim pjesë e ekipeve të ndihmës në shpërndarjen e pakove ushqimore, batanijeve, etj. Dëshira dhe vullneti për të ndihmuar këta njerëz sfidonte dëborën, akullin dhe temperaturat e ulta, tipike për zonat malore. Më ka mbetur në mendje, kur shkua për të shpërndarë ndihmat në një fshat. Ndër ata që përfituan ndihmë ishte dhe një zonjë në moshë, që banonte në një shtëpi të rrënuar, ku çatia ishte gjysmë e hapur, muret e dëmtuara. E gjithë shtëpia ngrohej nga një sobë e

vogël, që vështirë se ngrohte dhe veten. Vetëm të shikoje gëzimin e saj kur çuam pakot e ndihmave të Kryqit të Kuq. Në sytë e saj kishte lot gëzimi. Lot që më kanë prekur thellë, lot që kurrë nuk do t’i harroj. Dhe mendoj që sa më shumë t’i ndihmojmë këto familje, aq më shumë do të njohim botën e vështirësive ku ata jetojnë. Ndiem krenar që në çastet të tilla të vështirat dhe unë u gjenda pranë këtyre njerëzve në nevojë.

Quhem Valmir Cane. Jam vullnetarë i Degës së KK Korçë. Përballimi i situatës dimërore ishte një nga përvojat më mbresëlënëse, që kam përjetuar. Shpërndarja e ndihmave në mbi 40 fshatra të Bashkive Devoll, Korçë dhe Maliq ishte një angazhim që kërkonte një



bashkëpunim të mirë ndërmjet Degës së KK Korçë, Njësi Administrative, TAP-it dhe deri tek banori, përfitues i kësaj ndihme.

Të angazhuar në shpërndarjen e ndihmave, së bashku me një grup vullnetarësh, patëm mundësi të lëviznin në një territor shumë të gjerë, nga fshati Trestenik, në kufi me Greqinë, e deri në Panaritin e largët. Takuam shumë banorë, të moshuar dhe fëmijë që në çdo moment na qëndronin pranë për t’na ndihmuar gjatë shpërndarjes së ndihmave, e cila shpesh kryhej nën reshjet e dendura të borës dhe erës së fortë.

Pavarësisht vështirësive të motit, Ne ndjemë në çdo fshat vlerësimin për punën e shoqatës, morëm me vete urimet e ngrohta për kontributin e dhënë dhe shpresën se të gjithë së bashku mund të bëjmë më të mirën.



KONKURSI II KOMBËTAR NJË PROJEKT PËR PËRHAPJEN E VL

Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSJ) numëron në radhët e tij rreth 2500 vullnetarë, 70 për qind e të cilëve, janë të rinj të moshës 15-25 vjeç. Shoqata jonë punon në mënyrë të veçantë me vullnetarët e rinj në kuadër të Programit të Rinisë dhe të Edukimit humanitar, duke e përqendruar qasjen e vet, në tre drejtime kryesore: të rinjtë si vullnetarë, të rinjtë si përfitues dhe të rinjtë si liderë.

Aktivitetet e Programit të Rinisë dhe Edukimit humanitar janë tashmë tradicionale dhe vit pas viti, thelbi i



tyre nuk ndryshon sepse mbështetet te parimet themelore të Lëvizjes dhe te politikat e KKSJ-së për rininë dhe vullnetarët, por synohet që forma e tyre, kohëzgjatja e angazhimit, mënyra e motivimit dhe ndërgjegjësimi i aktivizimit, të jenë në përmirësim dhe në përpunim të vazhdueshëm.

Përfshirja e të rinjve veprimtaritë e organizatave humanitare, është një problem. Shpesh mjedisi që na rrethon shpesh karakterizohet nga mungesa e tolerancës, mungesa e kulturës për paqen, përdorimi i narkotikëve, diskriminimi, etj. Për t'iu përgjigjur nevojës së përcjelljes te të rinjtë të dobisë së kultivimit të vlerave humanitare dhe të ofrimit të mundësisë për të kontribuar

Programi i Rinisë dhe Edukimit Humanitar

synon të promovojë dhe zhvillojë vullnetarizmin te brezi i ri veçanërisht në drejtim të promovimit të vlerave humanitare dhe të parimeve themelore të Lëvizjes si dhe t'i aftësojë të rinjtë si liderë në dhënien e kontributit në komunitet.

në mbështetjen e njerëzve më në nevojë, nisi në vitin 2015, një aktiviteti me të rinjtë e shkollave të mesme, i konceptuar në formë konkursi.

Konkursi mori emrin “Rinia dhe Kryqi i Kuq” dhe kishte si qëllim të sjellë më pranë Kryqit të Kuq, të rinjtë në mënyrë që ata të njihen me Lëvizjen Ndërkombëtare të KK dhe të GjK, Parimet themelore të kësaj Lëvizje, programet e KKSJ dhe vlerat humanitare që bartin veprimtaritë e tij, gjithnjë me synim që nëpërmjet këtij procesi, të bëhen vullnetarë të shoqatës dhe qytetarë sa më të denjë për vendin. Në vitin e parë, Konkursi u zhvillua, si një projekt pilot vetëm në gjashtë degë.

Programi kërkon të sigurojë një përfshirje aktive të të rinjve në veprimtaritë dhe në vendimmarrjen e KKSJ-së, duke përmirësuar treguesit dhe standardet e aktiviteteve të ndryshme që zhvillohen në kuadër të programit për promovimin e vullnetarizmit te të rinjtë vullnetarë si mënyrë për të përmirësuar jetën e njerëzve në nevojë.

Puna me të rinjtë, takimet, idetë dhe energjia e tyre, sjell përherë një frymë të re për organizimin e veprimtarive dhe ide të reja për zbatimin e tyre.

Konkursi Kombëtar për vlerat humanitare “Rinia dhe Kryqi i Kuq” është një mundësi më shumë për të rritur bashkëpunimin mes të rinjve, për të përmirësuar punën në grup, por edhe për të mësuar shprehitë e të qenit drejtues. Këta të rinj do të jenë mbështetësit e shoqatës në shkollën e tyre, burimi kryesor dhe lidhja me komunitetin e veçanërisht me të rinjtë e tjerë, për promovimin e vlerave humanitare të Kryqit të Kuq.

Viti 2016 ishte viti i 95 vjetorit të krijimit të KKSJ, prandaj dhe dëshira ishte që në këtë aktivitet, të

përfshiheshin të gjitha degët e KKSJ. Pjesëmarrja e rreth 230 të rinjve në këtë veprimtari, kërkonte edhe një buxhet të rëndësishëm për realizimin e tij. Kjo ishte një sfidë më vete. Prandaj u hartua një projekt me titull “Të mësoj si të bëhem një lider - Të veproj si i tillë!”, me të cilin u aplikua pranë sekretariatit

Fondi i Perandoreshës Shòken

është krijuar nga Madhëria e saj Perandoresha e Japonisë, e cila në vitin 1912 propozoi krijimin e një fondi për mbështetjen në mbarë botën, të veprimtarive në kohë paqeje të shoqatave kombëtare të KK të GjK.

Fondi menaxhohet nga një Komision i Përbashkët i FNKK&GjK dhe KNKK.

Komisioni i Përbashkët vlerëson aplikimet e bëra, dhe shpall vendimet më 11 prill të çdo viti, në përvjetorin e vdekjes së Perandoreshës.

të “Fondeve Shòken”, i cili u miratua pa ndryshim dhe në këtë mënyrë u sigurua edhe mbështetja financiare për të.

Realizmi me sukses i projektit, kishte edhe sfida të tjera si ngritja e skuadrave cilësore të vullnetarëve në degë, përgatitja e pyetjeve të përshtatshme për 7 takimet konkurruese ku do merrnin pjesë skuadrat, koordinimi sa më i mirë i planit të konkursit me aktivitetet e degëve etj. Konkursi u zhvillua në 7 takime, 6 prej të cilëve ishin takime rajonale dhe 1 ishte takim final.

Takimi i parë dhe i dytë i Konkursit, u zhvillua në Degën e KK Durrës, më 24 shtator 2016. Morën pjesë 12 degë, secila me një skuadër prej 5 vullnetarë dhe fitues u shpallën ekipet e Degës së KK Durrës dhe Kukës. Takimi i tretë u zhvillua në Degën e KK Shkodër. Morën pjesë 6 degë, fitues u shpall skuadra e Degës së KK Shkodër. Në Elbasan u mbajt takimi i katërt, ku skuadra fituese u shpall ajo e Degës së KK Tiranë. Takimi i pestë u zhvillua në Fier dhe fituese doli

"RINIA DHE KRYQI I KUQ" ERAVE HUMANITARE TE TË RINJTË

skuadra e Degës së KK Kuçovë. Takimi i gjashtë u zhvillua në Gjirokastër ku u shpall fituese, skuadra e Degës së KK Gjirokastër.

Në ambientet e Qendrës Rinore në Tiranë, u zhvillua më 8 Tetor, takimi final i Konkursit II Kombëtar. Në takimin final morën pjesë ekipet fituese të dala nga gjashtë takimet e para. Në raundin final të këtij takimi dolën ekipet e Degëve të KK Durrës dhe Kuçovë. ndeshje gjatë së cilës skuadrat demonstuan angazhim, përgjegjësi dhe emocione të mëdha. Të dy skuadrat dhe të dhjetë të rinjtë vullnetarë janë fitues, pavarësisht se në fund të takimit, ishte skuadra e Degës së KK Durrës që u shpall fituese, dhe meritoi Kupën e Konkursit.

Gjatë gjithë takimeve kemi qenë dëshmitarë të një shpirti të fortë gare, jo vetëm nga të rinjtë vullnetarë. Jemi ndjerë krenarë që kemi punuar me vullnetarë të tillë, të përgjegjshëm për çfarë kishin marrë përsipër dhe të angazhuar deri në fund për ta përmbushur atë me sukses. Ishte një eksperiencë shumë e bukur, të cilën do të synojmë ta kthejmë në traditë.

Manjola Syknej
Koordinator e Programit të Rinisë
dhe Edukimit humanitar

INTERVISTË

Me Dr. Halil Stana,
ZvPresident i KKS
Kryetar i jurisë së
Konkursit "Rinia dhe
Kryqi i Kuq".



Çfarë ju erdhi në mend kur mësuar se do të ishit Kryetar i jurisë?

-Menjëherë mendova për një impenjim serioz që kërkonte ky proces, i cili do të synonte jo vetëm forcimin e dijeve të të rinjve, por edhe të kishte



një format interesant për të rinjtë që konkursi të ishte vlerësim dhe motivim për ta.

Si i patë të rinjtë në këtë aktivitet? Çfarë mendoni se sollën të rinjtë?

-Të rinjtë janë të etur për njohuri, por mënyra se si i shtron ato njohuri dhe si i motivon të rinjtë, si e ndërton dhe organizon aktivitetin, ka të bëjë shumë, gjë të cilën e pamë me vullnetarët e shumë degëve.

A u arritën pritshmëritë nga ana juaj për këtë aktivitet?

-Mbeta shumë i kënaqur me njohuritë e fituara prej të rinjve, çka u shpreh nëpërmjet përgjigjeve që u dhanë gjatë konkurrimit, rezultat i cili erdhi duke u rritur në fund të tij.

Cilat janë sugjerimet tuaja për konkursin e vitit të ardhshëm?

-Duhet filluar përgatitja më herët që degët të punojnë jo vetëm me një grup të vogël vullnetarësh. Numri i tyre të jetë sa më i madh, me qëllim që edhe përfitimi të jetë i tillë.

Si mund ta përkufizoni se çfarë ishte për ju ky aktivitet?

-Ishte një risi që duhet të vlerësohet dhe të vazhdojë të mbështetet nga të gjithë, veçanërisht nga degët. Aktiviteti nuk duhet të përfundojë me



përfundimin e konkursit, por të ketë vijueshmëri. Në këtë mënyrë njohuritë për KKS, për veprimtaritë që ai kryen, do jenë më të plota dhe kështu do të afrohen më shumë vullnetar të rinjsh.

Përshtypje nga vullnetarët që morën pjesë në Konkurs:

Artjola, vullnetare e Degës së KK Durrës, tani studente në Fakultetin Shkencor Mjekësore, shprehet se:

Falë mundësisë që pata këtë vit që të isha pjesë e Konkursit "Rinia dhe Kryqi i Kuq", kuptova se sa shumë e rëndësishme do të ishte që secili prej nesh, të mishëronte shtatë Parimet themelore të Lëvizjes për të vepruar dhe frymëzuar komunitetet e tyre. U bëra pjesë e konkursit me dëshirën për të mësuar më shumë rreth historikut të Kryqit të Kuq, Parimeve themelore dhe strukturave mbi të cilat funksionon kjo shoqatë. Puna në grup me vullnetarët e tjerë të degës, e bëri dhe më interesante ecurinë e konkursit.

Çdo pasdite mbledheshim së bashku, diskutonim rreth atyre që kishim lexuar. Fazat e konkurrimit mes Degëve të KK në Shqipëri, na dhanë mundësinë të njihnim bashkëmoshatarë të tjerë, me të cilët na bashkonte një qëllim: edukimi humanitar dhe vullnetar. Fitorja që na motivonte në fillim, tashmë nuk ishte më aq e rëndësishme. Ne kuptuam se që në momentin e parë që u bëmë pjesë e konkursit, fituam shoqërinë e njëri-tjetrit, zhvilluam aftësitë tona sociale, kreative dhe orientuese. Secili nga ne mund ta konsideronte veten një lider, pasi mbarte potencialin për të reflektuar tipare pozitive dhe për të futur në shoqëri, praktikën e një jetese të shëndetshme.

Orgesi, vullnetar i Degës së KK Kuçovë, skuadra e të cilës, fitoi Vendin e Dytë në konkurs.

Kohët e fundit jam lidhur më shumë me Kryqin e Kuq. Kjo ndodhi fill pas Konkursit mbi Vlerat Humanitare, ku unë u njoha më shumë me KKS. Do të thoja që konkursi ishte një eksperiencë mjaft e bukur pasi vuri në provë aftësitë e mia si lider i grupit, por edhe njohuritë e mia mbi Kryqin e Kuq. Mënyra e funksionimit të konkursit, na la të kuptonim që kjo shoqatë është e ndërtuar si një familje, ku secili jep kontributin e vet.

Stina e Pranverës sjell me vete dhe virozat karakteristike të saj. Mbas një furtune të fortë të virozëve të dimrit, që sapo kaluam, është rritur dhe vëmendja dhe ndërgjegjësimi i të gjithëve karshi tyre.

Nëse çdokush konstaton dhembje të lehtë të fytit, kollë të thatë dhe rrufë, duhet të paraqitet menjëherë pranë mjekut të familjes.

Nuk këshillohet shkuarja direkt në farmaci dhe aq më tepër marrja e antibiotikëve nga vetë pacienti ose të rekomanduara nga farmacisti. Është i njohur fakti që virozat mjekohen pa antibiotikë, pasi ky i fundit, siç dihet tashmë, nuk ka asnjë lloj efekti ndaj virusit. Përdorimi pa kriter i antibiotikëve sidomos në rastin e virozëve, sjell rezistencë bakteriale, e cila është rritur në mënyrë të frikshme kohët e fundit, sidomos në vendin tonë. Kështu që është me vend të theksojmë dhe njëherë rëndësinë që merr kontakti fillestar i gjithsecilit me mjekun e familjes.

Virozat e Pranverës kanë si karakteristikë të veçantë, përveç shenjave që përmendëm më lart, sekrecionet nazale, dhimbje fyti, kollë të thatë që shoqërohen me lotim sysh, skuqje të tyre, teshtima të shumta, sidomos në mëngjes.

Kjo stinë përveç virozëve, sjell dhe fenomenet alergjike të cilat janë shtuar së tepërmi kohët e fundit. Ndër këta faktorë të shumtë, ndër të cilët mund të përmendim ndotjen e ajrit, kjo sidomos të kryeqytet, stili i jetesës, mënyra e të ushqyerit, etj. ka bërë të ulet mosha e prekjës së individit nga këto fenomene alergjike.

Por, të kthehemi tek virozat e stinës: Mjeku i familjes pasi bën vizitën, vlerëson situatën dhe jep rekomandimet përkatëse me antisimptomatikë. Rekomandohet përdorimi i Vitaminës C, përdorimi i lëngjeve me shumicë, përdorimi i antipiretikëve (Paracetamol, Aspirinë, ose i antigripeve që qarkullojnë në çdo farmaci). Është e rëndësishme të theksohet se, nëse temperatura zgjat më shumë se 5 ditë, të bëhet një rikontroll

te mjeku i familjes, i cili rekomandon analizat përkatëse dhe ribën një vizitë të dytë për të parë shfaqjen e komplikacioneve.

Grup moshat më delikate që duhet të jenë nën observacioni e mjekut të familjes janë fëmijët dhe mosha e tretë, sidomos pacientët me diagnoza kardiale apo dhe të tjera diagnoza, si Diabet Mellitur, apo dhe çdo sëmundje tjetër kronike. Në këto raste komplikacionet nga virozat janë më të shpeshta e më të mundshme. Kur konstatohen komplikacione, përdorimi i antibiotikëve është i pashmangshëm dhe në raste të veçanta konsulta me mjekun specialist është e vlefshme.

*Dr. Ilta Sinojmeri
Mjeke Familje*



Ilta Sinojmeri, e diplomuar si mjeke e përgjithshme në vitin 1991, punon si mjeke e përgjithshme, familje në Qendrën Shëndetësore Nr. 5, Tiranë. Ilta është anëtare e Këshillit të Degës së Kryqit të Kuq, Tiranë nga viti 2014. Si anëtare e Këshillit të Degës ajo kujdeset veçanërisht, për mbarëvajtjen e veprimtarive që organizohen në kuadër të Programit të Shëndetit.



“Jo indiferentizmit... Po solidaritetit” një fushatë në ndihmë të fëmijëve sirianë

Ndihmë popullit sirian, e veçanërisht fëmijëve që po vuajnë pasojat e një lufte, tashmë tepër të gjatë e me pasoja mjaft të rënda, imazhet e së cilës janë tepër prekëse. Qytete të tëra në luftë, tërësisht të shkatërruara, dhe një luftë që nuk kursen askënd. E ndërmjet tyre, fëmijët janë më të rrezikuarit. “T’i vimë sadopak në ndihmë fëmijëve sirianë”, ishte dhe qëllimi i nismës së ndërmarrë nga Kryetari i Qendrës së Bashkëpunimit Ndërfetar, (QBNF) Elbasan Dr. Arben Ramkaj dhe Presidenti i KKSH, z. Ylli Alushi.



Në prani të përfaqësuesve të të gjitha feve, dy kryetarët bënë të njohur këtë iniciativë për publikun, në Sallën e Konferencave të Hotel “Skampa” Elbasan, duke i bërë thirrje të gjithë individëve dhe bizneseve të japin kontributin e tyre për fëmijët në nevojë në Siri. Iniciativa gjeti mbështetjen e medias lokale dhe asaj kombëtarë. Në fjalën e tij, koordinatori i QBNF, z. Sokol Lulgjuraj, u shpreh se gjithçka që do të mblidhen gjatë kësaj fushate, do të kalojnë në Llogarinë e Kryqit të Kuq Shqiptar, hapur enkas për këtë qëllim, dhe do të përcillen në destinacion nëpërmjet strukturave të Lëvizjes Ndërkombëtare të KK dhe të GjK për fëmijët në Siri. Strukturat e Lëvizjes ndërkombëtare të KK dhe të GjK janë prezentë në Siri që me fillimin e konfliktit. Presidenti i KKSH, z. Ylli Alushi, pasi falënderoi QBNF-në për iniciativën dhe ftesën për bashkëpunim, premtoi angazhimin maksimal të shoqatës në një fushatë në të gjithë degët e saj në mbarë vendin, si dhe garantoj transparencë e siguri për mbërritjen në destinacion të kontributeve me logon:

“N d i h m ë e popullit shqiptar për fëmijët sirianë”.

Kryetari i QBNF-së Elbasan, dr. Arben Ramkaj, theksoi gjendjen e rëndë që po përjeton populli dhe fëmijët sirianë duke treguar arsyet që e shtynë këtë Qendër të merrte këtë iniciativë. Ndërkohë që famullitari i Kishës Katolike Shën Piu X, Elbasan, Don Emilio Valente, u bëri thirrje të gjithë besimtarëve Katolikë që të kontribuojnë sipas mundësive në këtë dhurim. Ndërkohë që At Gjergji Trebicka dhe Dervish Ardit Selmani, u bënë thirrje besimtarëve ortodoksë e bektashianë në mbarë vendin, që t’i bashkoheshin fushatës. Një thirrje të tillë bëri dhe Myftiu i Elbasanit, Haxhi Agim Duka për besimtarët myslimanë që të ndihmojnë në këtë dhurim.

Pas mbarimit të fjalës së tij Myftiu Duka, që i pari që dhuroi 500.000 lekë. Dhurimit ju bashkua edhe shoqëria e sigurimeve “SIGAL”, që, nëpërmjet drejtorit të saj në Elbasan, z. Klevis Çullhai, e vlerësoi këtë fushatë dhe theksoi se “SIGAL” nuk mund të mungojë në raste të tilla. Ai dhuroi 100.000 lekë.

Fushata kulmoi në datën 14 Janar me Marshimin e “Paqes 2017- “Jo, Indiferentizmit ... Po, Solidaritetit!” Marshimi nisi nga sheshi i stadiumit “Elbasan Arena” dhe vazhdoi përgjatë gjithë bulevardit kryesor të qytetit të Elbasanit. Ai u përshëndet nga oratorë të ndryshëm, si Don Emilio Valente dhe Kryetari i Bashkisë, Z. Qazim Sejdi, deputetët Evis Kushi, Arbjola Halimi, Luçiano Boci, Taulant Balla, Prefekti i Elbasanit, kryetari i Këshillit të Qarkut, Rektori i Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, përfaqësues të komunitetit mysliman, ortodoks, dhe Vëllazëria



Ungjillore, si dhe Presidenti i KKSH z. Ylli Alushi.

Një marshim i tillë në mbështetje të fëmijëve dhe të gjithë atyre që vuajnë në Siri, është një shembull i mrekullueshëm sesi i gjithë komuniteti në Shqipëri di të bëhet bashkë, në ndihmë të atyre që vuajnë.

Fushata u prit shumë mirë, dhe pati një jehonë të gjerë në media ku një kontribut të veçantë dha Radio “Albania FM” e cila realizoi dhe një emision të posaçëm dhe TV Lokale që e pasqyruan gjerësisht çeljen dhe vazhdimësinë e fushatës.

Pikërisht në ditën e hapjes së fushatës, u realizuan dhe donacione të rëndësishme në ndihmë të njerëzve në nevojë në Siri, sic ishte ato nga “Myftinia Elbasan” 500.000 leke, Shoqëria e Sigurimit “SIGAL”, Kryqi i Kuq Shqiptar, etj.



Shoqëria jonë ka nevojë të edukohet me njerëzoren

Intervistë me znj. Valbona Selimllari - Fituese e Konkursit të Parë “Miss Albania”

Pyetje : Të gjithë e dinë se Ju jini “Miss Albania e parë”, ndërkohë që kini një jetë mjaft aktive në fushën e artit. Si është jeta e një Miss-i në Shqipëri, dhe lidhjet e saj me çështjet sociale që shqetësojnë vendin?

Ndonëse ajo që më bëri të njohur është kurora e Miss-it, ajo çfarë gjithmonë kam synuar të përcjell është ideja se “mbretëreshë nuk të bën kurora e bukurisë fizike, por ajo e mirësisë”. Ikona e bukurisë Audrey Hepburn* thoshte gjithmonë se bukuria e një femre nuk qëndron tek tiparet e fytyrës së saj, por reflektohet në shpirtin e saj. Ajo shfaqet në përkujdesjen që ju i dhuron të tjerëve dhe në pasionin me të cilin ndihmoni njerëzit.

Unë ka shumë vite që jam pjesë e botës së artit dhe televizionit. Në paraqitje të tilla skenike, mundohem sadopak të kontribuoj në zgjidhjen e kauzave sociale. Çështjet sociale që Ju përmendni i kam shumë përzemër, dhe kjo më ka bërë të jem dhe pjesë e Kryqit të Kuq Shqiptar. Që në momentin e parë, kur u kurorëzova si Miss Shqipëria, jam munduar të jap shembullin tim personal, të ndihmoj njerëzit në nevojë. Shpesh mjafton një fjalë e mirë, pse jo një gjest i thjeshtë për të ndihmuar të tjerët. Mos u kurseni, bashkë vërtetë mund të bëjmë diferencën!

Pyetje: Jini e njohur për jetën tuaj aktive dhe në lëmin e vullnetarizmit, duke qene prej vitesh një vullnetare e spikatur e KK. Përse kjo zgjedhje? Përse me Kryqin e Kuq Shqiptar?

Ndoshta sepse kam një natyrë shumë altruiste, sepse dua të ndihmoj ata që janë në nevojë. Kam dhënë kontributin tim më shumë te Kryqi i Kuq, sepse kam ndjerë se si kjo shoqatë humanitare, më e madhja në vend, është gjendur gjithnjë pranë atyre që kanë nevojë, qofshin këta pacientë apo individë që kanë nevojë për gjak; një familje në nevojë, apo dhe komunitete të tëra familjesh në nevojë, të prekura nga

përmbytjet, dimri i acartë, temperaturat e nxehta, apo dhe katastrofave që janë shkaktuar nga dora e njeriut. Vështirë të mos kujtohet, ajo që ka bërë Kryqi i Kuq në vitin e mbrapsht 1997, apo gjatë krizës kosovare.

Pyetje: I jeni bashkuar çështjes së KKSH për dhurimin vullnetar të gjakut, duke dhuruar dhe vetë për të disatën herë. Përse?

Unë jam nënë, jam qytetare, jam familjare. Gjithkush, ka përjetuar në një moment të caktuar, ankth, shqetësim, dhe frikë për fatin jetësor të një të afërmi, të një miku të sëmurë, jeta e të cilit varej shumë nga marrja e një sasive të caktuar gjaku, ashtu siç kemi përjetuar pasigurinë nëse ky gjak ka qenë i sigurt apo jo. Kemi ndjerë të jemi të lehtësuar dhe të gëzuar, kur njeriu ynë ka marrë gjakun e nevojshëm dhe jeta e tij është shpëtuar. Me vete kemi falënderuar me gjithë zemër, dhuruesit, por dhe KK që ka përqafuar dhe është vënë në ballë të kësaj iniciative për të siguruar gjak të mjaftueshëm dhe të sigurt në vend. Është kjo arsyeja që na shtyn të reflektojmë me veten dhe një ditë të vendosim të dhurojmë gjak. Me fjalë të thjeshta, dhurimi që bëjmë sot, është një shërbim që i bëjmë vetes nesër. Nëse larg qoftë, një ditë do të ishim ne vetë nevojtarë, dikush tjetër do të dhurojë për ne.

Pyetje: A mendoni se arti dhe shoqëria civile mund të bëjnë më shumë në ndihmë të njerëzve në nevojë?

Sigurisht që mund të bëjnë shumë e shumë me tepër. Arti, shoqëria civile është shumë e lidhur, në rastin konkret me imazhin që përcjellin. Nëse imazhi ofrohet për komercialitet, dhe këtu nuk ka asgjë të keqe, nuk ka arsye që të mos ofrohet për njerëzoren, humanen, sepse në këtë rast qëllimi është ndihma, pse jo dhe edukimi. Shoqëria jonë ka nevojë të edukohet me njerëzoren, me solidaritetin me njerëzit në nevojë, në kushtet kur shoqëria po bëhet gjithnjë e më polarizuar. Vrapimi pas fitimit



jo gjithnjë te jep kënaqësinë që të jep shpëtimi i një jete, apo lehtësimi i një vuajtje; gëzimin që të jep sjellja e buzëqeshjes në fytyrën e një fëmije.

Pyetje: Në një farë mënyre jeni bërë imazhi i veprimtarive të KKSH në fushën e dhurimit të gjakut dhe në atë ndihmës për më nevojtarët. Çfarë sjell për Ju dhe si e përjetoni këtë fakt?

Një pyetje mjaft e gjetur. Ju siguroj se në këtë marrëdhënie të krijuar ndërmjet meje dhe KKSH, nuk është vetëm ky i fundit që përfiton. Po aq sa përfiton shoqata nga kjo marrëdhënie, po aq në mos më shumë përfitojmë ne përfaqësuesit e artit. Jo gjithçka është para! Fitojmë njerëzoren! Fitojmë miqësinë!

***Audrey Hepburn** (1929 – 1993) ka qenë një aktore, modele dhe kërcimtare britanike, por dhe një humaniste e spikatur. Ajo ishte shumë e dedikuar për të ndihmuar fëmijët e në kombet e prapambetura.

Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Kryqit të Kuq Shqiptar dhe Kryqit të Kuq të Kosovës

Në Selinë e Kryqit të Kuq Shqiptar (KKSH) u organizua ceremonia e nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Kryqit të Kuq Shqiptar dhe Kryqit të Kuq të Kosovës (KKK). Pas një historie suksesi bashkëpunimi në vite, shoqatat kanë rënë dakord që ta forcojnë këtë frymë bashkëpunimi në një marrëveshje dyvjeçare, për periudhën 2017-2018.

Marrëveshja u nënshkrua nga Presidenti i KKSH, z. Ylli Alushi dhe Presidenti i KKK, z. Adem Nura. Ceremoninë e nderoi me pjesëmarrjen e tij Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozi.

Objekt i kësaj marrëveshje janë veprimtaritë humanitare të zhvilluara në fusha të ndryshme të veprimtarisë të të dyja shoqatave. Ky bashkëpunim synon pikësisht të lehtësojnë ndihmën ndërkufitare për njerëzit e prekur nga katastrofat natyrore, konfliktet e

armatosura apo krizat e ndryshme, me qëllim përmirësimin e nivelit të shërbimeve për të gjithë njerëzit në



nevojë, nëpërmjet shkëmbimit të përvojës.

Takime të rregullta të nivelin më të lartë të përfaqësuesve të guvernancës dhe të menaxhimit të dy shoqatave simotra; organizimi i veprimtarive të përbashkëta, ndërmjet të rinjve të KKSH dhe të KKK, për promovimin e vlerave humanitare, dhënien e Ndhmës së Parë, etj.; bashkëpunim dhe shkëmbim

përvoja në fushën e menaxhimit të katastrofave, të ndihmës humanitare të ndërsjellë, mbështetjes psiko-sociale

të të prekurve nga katastrofat dhe krizat humanitare; bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojës në fushën e shërbimit për emigrantët dhe refugjatët dhe Rivendojen e Lidhjeve Familjare; bashkëpunim dhe shkëmbim përvojë në fushën e Kujdesit Shëndetësor; Dhurimin Vullnetar të Gjakut dhe Promocionin e një shëndeti

të mirë; dhe më në fund bashkëpunim dhe shkëmbim përvojë në fushën e shërbimeve sociale janë dhe drejtimet kryesore që kjo marrëveshje synon të promovojë në shkallën më të lartë.


Përvoja e deritanishme e bashkëpunimit e KKSH dhe KKK, është një garant për rezultatet që do të sjellë zbatimi i kësaj Marrëveshje.

Një letër falënderuese

Një letër falënderuese e gjetur nën derën e ambienteve tona të punës, është më e bukur se çdo urim apo kartolinë urimi për një fillim viti të mbarë.

Është kënaqësi e veçantë, kur përkujdesja për njerëz në nevojë, shpërblehet me këtë gjest mirësie nga njerëz të varfër por me shpirt të pasur.

Ju duam të gjithëve, duke shpresuar që nga dita në ditë t'ju qëndrojmë sa më pranë. ❤️



10 JANAR

Nëse ka një moment, një ditë për të bërë aktin e ndihmës për bashkëqytetasit në nevojë, është sot! Qendrat Sociale pritëse të Bashkisë Tiranë kanë SOT



nevojë për solidaritet! Ekipi drejtues i Agjencisë së parqeve dhe të Rekreacionit (APR) dhuroi 40000 lekë të reja këpucë e veshje, Kryqi i Kuq Shqiptar dhuroi 60 000 lekë të reja batanije e ushqime dhe Qendra Vullnetare e Emergjencave Civile dhuroi një sasi veshjesh, ilaçe, dyshekë e ushqime.

11 JANAR

Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Dibër - Aty ku ka më shumë nevojë, në këto ditë të acarta dimri .



19 JANAR

TAP (Trans Adriatic Pipeline) dhe KKSJH ndihmojnë 1300 familje në nevojë të prekur nga temperaturat e acarta të këtij dimri në rreth 100 fshatra, përgjatë rrugës që ndjek tubacioni i gazsjellësit. KKSJH është përgjegjës për pjesën logjistike të shpërndarjes së ushqimeve dhe batanijeve për përfituesit nëpërmjet degëve të tij, në rajonin e Fierit, Beratit dhe Korçës. Nga kjo do të



përfitojnë ndihmë rreth 6000 banorë. Më 17 janar, Dega e KK Korçë realizoi shpërndarja e parë në zonën e Devollit ku u ndihmuan fshatrat Trestenik, Vishockë, Kuç, Poloskë dhe Bilisht.

28 janar

Dega e KK Durrës shpërndau ndihma ushqimore dhe batanije për familjet më në nevojë në Sukth.

2 SHKURT

Programi për Përgatitje dhe Ndërhyrje në raste katastrofash dhe Ndihmë të Parë, organizoi takimin e vlerësimit të



operacionit të ndihmës për përmytjet e fundvitit dhe vështirësitë e dimrit, nëntor 2016 - janar 2017

Në takim morën pjesë përfaqësues nga 10 degë të KKSJH të prekur nga përmytjet e fund vitit të kaluar, kryesisht të mbështetura nga DREF (Fonde të Federatës ndërkombëtare



destinuar për situata emergjente) dhe degë të angazhuara në përballjen e vështirësive të krijuara nga moti i acartë në këtë fillim viti. Në takim mori pjesë përfaqësues të Zyrës Rajonale të FNKK&GJK në Budapešt. Pjesëmarrësit diskutuan gjerësisht për efektivitetin e ndërhyrjes së realizuar, pikat e forta dhe të dobëta që u vërejtën dhe masat që duhen marrë nga strukturat përkatëse në seli dhe në degë për përmirësimin e tyre.

6 SHKURT

Ndihma e Parë në stadium - Falë bashkëpunimit ndërmjet KKSJH dhe Federatës Shqiptare të Futbollit, ekipet



e Ndihmës së Parë të Kryqit të Kuq të degëve ku luhen takimit e Kategorisë Superiore të Futbollit, nisën të asistojnë ndeshjet e zhvilluara prej ekipeve të kësaj kategorie. Vullnetarët qëndrojnë në gatishmëri për çdo rast dëmtimi në fushë dhe jashtë saj. Ky është një tjetër shërbim që KKSJH organizon për komunitetin, në rastin konkret për sportistët dhe sportdashësit!

8 SHKURT



... ishte një ditë e një trishtimi të thellë për Lëvizjen ndërkombëtare të KK dhe të GjK. Në Afganistan u vranë 6 punonjës të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe 2 punonjës janë zhdukur. Në Siri në Alepo u vra një punonjës humanitar dhe 7 vullnetar dhe punonjës të stafit u plagosën. Në Siri në Idelib, një punonjës humanitar, së bashku me gruan dhe dy fëmijët u gjetën në rrënojat e një pallati. Fushata ka gjetur mbështetjen e shumë shoqatave e mjaft individëve në mbarë botë.

10 SHKURT

“Dhuro Gjak, Shpëto Jetë!” Ky është viti i 11-të radhazi që Ambasada Amerikane organizon fushatën e



dhurimit të gjakut, në bashkëpunim me KKSH dhe Bankën Kombëtare të Gjakut. Gjithkush mund të japë kontributin e tij. Mjaft që t'i kërkonti Kryqit të Kuq Shqiptar të organizojë një fushatë për dhurimin vullnetar të gjakut në vendin tuaj të punës apo të studimit.

13 SHKURT

KKSH i bashkohet fushatës së Lëvizjes ndërkombëtare të KK dhe GjK “I am not a target” (Unë nuk jam objekt për t'u marrë shenjë).



14 SHKURT

Edhe Kryqi i Kuq Shqiptar i bashkohet festës së të dashuruarve.



24 SHKURT

Sudani i Jugut – Riciklimi i dhunës çon vendin në një paqëndrueshmëri të thellë




Gratë, fëmijët dhe të moshuarit, vetëm pas një muaji, e gjejnë sërish vetën të jetojnë në zonat e largëta moçalore, duke mbijetuar vetëm falë frutave të egra. Kur të kthehen në shtëpi, do t'i gjejnë sërish të plaçkitura. Përsëritja shpesh e kësaj situate, e bën të pamundur sjelljen në normalitet. Zhvendosjet e përsëritura, mungesa e respektit për civilët dhe pronës, shkatërrimi i tregjeve dhe tregtisë nga konfliktet e armatosur – e kanë sjellë në vend pasoja shkatërrimtare për njerëzit. KNKK bën apel për pushimin e dhunës në vend dhe krijimin e kushteve për organizimin e ndihmës për më nevojtarët.

28 SHKURT

Apel i KNKK për krizën në Siri

Gjashtë vjet dhunë në Siri kanë sjell shumë vdekje dhe shkatërrim. Miliona njerëz kanë qenë të detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre, ose janë larguar nga vendi. Shumë prej tyre janë fëmijë. Pavarësisht nga rreziqet, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, që nga fillimi i konfliktit, ka ofruar ushqim dhe mbështetje jetëshpëtuese për sirianët. Së bashku me Gjysmëhënën e Kuqe Arabe



Siriane, KNKK është nga të paktat organizatat humanitare që mund të ndihmojnë njerëzit e vështira për tu arritur si pasojë e konfliktit. Në 15 vitet e fundit, kjo krizë është më i madhe humanitare.

28 SHKURT

Më shumë dashuri njerëzore, më shumë buzëqeshje, shpresë dhe jetë nga qytetarët që dhuruar vullnetarisht gjak për ata që kanë nevojë, veçanërisht fëmijëve të sëmurë me Talasemi. Vullnetarët dhe stafi i KKSH, në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Kombëtare të Gjakut, ju përgjigjen gatishmërisë të punonjësve e studentëve nga fusha të ndryshme të jetës si ajo e artit, kulturës, shkencës, arsimit, ushtrisë, policisë, etj. për të dhuruar gjak vullnetarisht.



Të gatshëm u treguan punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Rrugëve, Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, studentet e Universitetit “Polis”, Akademia e Biznesit, nxënësit e Shkollës të Mesme të Kuzhinës “Hysen Çela” në Durrës, studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan, Policia dhe administrata e Institutit të Riedukimit në Fier, sportistët e Tirana MMA Centre,

vijon në faqen 18

Nga veprimtaritë e KKSH dhe të Lëvizjes ndërkombëtare të KK & GjK

vullnetarë nga qyteti i Vlorës, Korçës, Beratit, Lushnjës, Pogradecit e të tjerë. Gjatë këtij muaji janë 420 vullnetarë që kanë shprehën gatishmërinë e tyre për të dhuruar gjak.

8 MARS

Gëzuar 8 Marsin! Ky është urimi që Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Gjirokaštër u bën të gjitha grave shqiptare! Vullnetarët e Degës së KK Gjirokaštër



dhuruan lule dhe uruan festën derë më derë dhe në Shtëpinë e të Moshuarve, Gjirokaštër, te nënat, gratë, gjyshet, të cilat jeta i ka përballur jeta me sfida mjaft të vështira.

11 MARS

2017 u zhvillua "Konkursi i Ndhmës së Parë, Tirana 2017", te Parku i Liqenit me pjesëmarrjen e vullnetarëve të ekipeve konkurruese, etj.



Jo vetëm që vullnetarët e trajnuar u testuan për njohuritë e tyre teorike dhe praktike por njëkohësisht i

demonstruan këto rreth një publiku të gjerë dhe 120 studentëve të cilët ndoqën konkursin duke treguar rëndësinë e zbatimit të këtyre masave jetë-shpëtuese. Falënderojmë të gjithë vullnetarët, instruktorët e ndihmës së parë, stafin dhe anëtarët drejtues të degës Tiranë për realizimin e këtij aktiviteti. Suksese ekipit përfaqësues në konkursin Rajonal!

13 MARS

Përfundoi Kursi 5-mujor i rrobaqepësisë për gratë dhe vajzat në nevojë, i organizuar nga Dega e Kryqit të Kuq, Korçë.



15 MARS

Izmir Smajlaj, kampioni i Europës në kërcim së gjati për salla të mbyllura, i bashkohet iniciativës së Kryqit të Kuq Shqiptar për të dhuruar gjak vullnetarisht për fëmijët talasemikë. Faleminderit Izmir dhe në emër të fëmijëve!



24 MARS

Çelet Ekspozita Vizatimore "Fëmijët dhe Kryqi i Kuq" organizuar nga Dega e Kryqit të Kuq Fier. Në këtë ekspozitë marrin pjesë nxënësit e 15 shkollave 9-vjeçare të qytetit të Fierit. Ekspozita është fryt i një fushate të gjerë për promovimin e Parimeve

Themelore dhe vlerave humanitare që mbartin veprimtaritë e Kryqit të Kuq. Në punimet e tyre nxënësit kanë shprehur atë që ata mendojnë dhe kanë dëgjuar për kryqin e kuq. Ekspozita u organizua në bashkëpunim të ngushtë



me Drejtorinë Arsimore, Fier. Punimet më të mira u nderuan me çmime. Në ceremoninë e hapjes së ekspozitës morën pjesë dhe përfaqësues të Drejtorisë Arsimore, Bashkisë, Prefekturës dhe Qarkut Fier, të cilët i falënderojmë për pjesëmarrjen dhe mbështetjen e tyre në këtë veprimtari!

27 MARS

U zhvillua Konkursi i Ndhmës së Parë në Degë e Kryqit të Kuq, Shkodër. Pjesë e sensibilizimit të komunitetit nga Kryqi i Kuq Shqiptar, është dhe Konkursi që organizohet çdo vit në shkallë kombëtare, e kështu dhe nga Dega e KK Shkodër.



Niveli i lartë i treguar në konkurs, u arrit falë punës së shkëlqyer të vullnetarëve, që pavarësisht ngarkesës shkollore, u impenjuan çdo ditë maksimalisht për një përgatitje sa më të mirë nga instruktorët e përkushtuar të Ndhmës së Parë në Degë, të cilët meritojnë të falënderohen për përkushtimin dhe dëshirën për të bërë më të mirën.

Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq

dhe e Gjysmëhënës së Kuqe në të cilën bën pjesë edhe Kryqi i Kuq Shqiptar, përfshin tre përbërës: Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), Federatën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (Federata Ndërkombëtare) dhe Shoqatat Kombëtare.



Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) si organizatë e paanshme, neutrale dhe e pavarur, ka misionin e posaçëm humanitar për të mbrojtur jetën dhe dinjitetin e viktimave të luftës dhe të dhunës së brendshme si dhe për t'u dhënë atyre ndihmë. Ai drejton dhe koordinon aktivitetet ndërkombëtare të ndihmës së gjithë Lëvizjes, në situatat e konflikteve. Përpiqet gjithashtu që të parandalojë vuajtjen njerëzore nëpërmjet promovimit dhe forcimit të së drejtës dhe parimeve humanitare universale. I krijuar më 1863, KNKK-ja është në origjinë të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe. Ai e ka njohur Kryqin e Kuq Shqiptar, në vitin 1923.

Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe, anëtar i së cilës është dhe Kryqi i Kuq Shqiptar që nga viti 1923, i përkushtohet sipas Parimeve themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, frymëzimit, favorizimit dhe promovimit të aktiviteteve humanitare të zhvilluara prej Shoqatave Kombëtare me qëllim përmirësimin e gjendjes së njerëzve më në nevojë. E themeluar më 1919, Federata Ndërkombëtare drejton dhe koordinon ndihmën ndërkombëtare të Lëvizjes për viktimat e katastrofave natyrore apo teknologjike, për refugjatët dhe për rastet e situatave të jashtëzakonshme shëndetsore. Ajo inkurajon bashkëpunimin mes Shoqatave Kombëtare dhe përpiqet që të formojë kapacitetin e tyre për realizimin e programeve efikase në fushat e përgatitjes për ndërhyrje në raste katastrofash, shëndetit dhe ndihmës sociale.

Shoqatat Kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (një prej të cilave është dhe Kryqi i Kuq Shqiptar) vënë në jetë qëllimet dhe parimet e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në 186 vende të botës. Ato përbushin atje rolin e ndihmësve të pushtetit publik për gjithçka që lidhet me çështjet humanitare dhe kryejnë veprimtari në fusha të tilla si: ndihma në rastet e katastrofave, shërbimet në sektorin e shëndetit dhe ndihma sociale. Në raste lufte ato i japin ndihma popullsisë civile të prekur prej saj dhe u ofrojnë mbështetje shërbimeve shëndetsore të ushtrisë.

Të gjithë përbërësit e **Lëvizjes Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe** udhëhiqen nga shtatë parimet themelore:

humanizmi, paanësia, asnjëanësia, pavarësia, vullnetarizmi, uniteti dhe universaliteti

Po ashtu dhe të gjitha aktivitetet e Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe synojnë të njëjtin objektiv: **të ndihmojnë ata që vuajnë, pa asnjë lloj diskriminimi, duke kontribuar kështu për paqen në botë**

Kryqi i Kuq Shqiptar

24 **365** **96**
orë **ditë** **vjet**



Në ndihmë të më nevojtarëve!

Kryqi i Kuq Shqiptar